

## INVESTITORË KUJDES! Mos investoni në platformën online FXLIDER

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2017
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2017

### Zhvillime të tjera

- Zhvillohet Mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF)
- “Sfidat dhe Praktikrat e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Evropën Juglindore”, Konferenca e IV-t e Evropës Juglindore për mbikëqyrjen e sigurimeve
- AMF zhvillon më tej bashkëpunimin me Shoqatën e Siguruesve të Austrisë (VVO) dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA)
- AMF organizon trajnimin e TAIEX mbi abuzimin e tregut dhe tregtimin e brendshëm në fushën e titujve
- Zhvillohet takimi i 27-të vjetor i Institutit të Rritjes dhe Zhvillimit të Tregut të Letrave me Vlerë

### Edukimi i Konsumatorit

- Metamorfoza e Greqisë dhe roli i industrisë së sigurimeve – Kujdestarët e së ardhmes? Fjala e Z. Yannis Stournaras, Guvernator i Bankës së Greqisë, mbajtur gjatë Forumit të Parë mbi Sigurimet organizuar nga “Ekonomisti” në Athinë, më 30 mars 2017  
(Marrë me shkurtime dhe redaktime - Pjesa e parë)

### Lajme Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Gjeorgji
- Serbi
- Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## **INVESTITORË KUJDES! Mos investoni në platformën online FXLIDER**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paralajmëron investitorët për rrezikun e investimit në platformën online <http://www.fxlider.com>

Mbështetur në Ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt” dhe Vendimin nr. 55, datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, një shoqëri brokerimi e huaj lejohet të ofrojë shërbimet e saj përmes një “agjenti”, themeluar si shoqëri brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pas miratimit nga AMF.

Platforma [www.fxlider.com](http://www.fxlider.com) nuk ka një agjent të miratuar nga AMF për të ofruar shërbime investimi në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë arsye AMF i bën thirrje investitorëve të bëjnë shumë kujdes përpara se të marrin një vendim në lidhje me pranimin e një oferte të paraqitur në faqen e internetit [www.fxlider.com](http://www.fxlider.com), ose një ofertë nga kontaktimet nëpërmjet telefonit, pasi AMF nuk monitoron ligjshmërinë e aktivitetit të shoqërisë së brokerimit të huaj që zotëron platformën [fxlider.com](http://www.fxlider.com) dhe AMF nuk mund të jetë në mbrojtjen e interesave të investitorëve, të cilët përballen me kompani apo persona, të cilët nuk kanë marrë miratimin nga AMF.

Lista e shoqërive të licencuara nga AMF për ofrimin e shërbimeve për investime mund të gjendet në faqen zyrtare të AMF-së në linkun e mëposhtëm: <http://www.amf.gov.al/tletrave.asp?id=1&s=1>.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-mars 2017 kapën vlerën mbi 3.46 miliardë lekë, ose 17.62% më shumë se gjatë periudhës janar-mars 2016. Gjatë periudhës janar-mars 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 275,020 me një rritje prej 23.65% krahasuar me periudhën janar-mars 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 83.70% në krahasim me periudhën janar-mars 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.78 miliardë lekë, apo 52.85% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 17.98% gjatë periudhës janar-mars 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-mars 2016.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 2.08 miliardë lekë gjatë periudhës janar-mars 2017, duke shënuar një rritje prej 13.87% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 60.29% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 11.54% të tregut të Jo-Jetës;

- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 8.40% të tregut të Jo-Jetës.


### Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 23.34% krahasuar me periudhën janar-mars 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit "Jetë debitor", e cila përbën 65.28% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 2.08 miliardë lekë gjatë periudhës janar-mars 2017.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-mars 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



## Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2017

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2017 u dominua në masën 57.15% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 42.85% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 94.76% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2017 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 58.19% dhe 30.93% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryen 100% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2017 u dominua në masën 57.15% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër.

- A. Blerje në tregun primar
- B. Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C. Blerje para afatit të maturimit
- D. Vendosje e bonos si kolateral
- E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim

### Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B** “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-mars 2017, ka pasur një ulje prej 413 milionë lekë ose 19.44% krahasuar me periudhën janar-mars 2016. Gjithashtu dhe numri i transaksioneve është ulur në masën 46.37%.

Transaksioni i llojit **C** “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-mars 2017 ka pasur ulje prej 291 milionë lekë ose 35.88% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 19.05%, krahasuar me periudhën janar-mars 2016.

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 704 milionë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.




Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 704 milionë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
	2016	2017	
<b>Letra me Vlerë të Qeverisë</b>			
<b>B</b>	<b>2,123,87</b>	<b>1,710,94</b>	<b>-19,44</b>
Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar			
Individë	1,956,87	1,710,94	-12,57
Persona juridikë	167,00	-	-100,00
<b>C</b>	<b>810,61</b>	<b>519,79</b>	<b>-35,88</b>
Blerje para afatit të maturimit			
Individë	710,61	519,79	-26,85
Persona juridikë	100,00	-	-100,00

Letra me Vlerë të Qeverisë 2017 / Government securities 2017



# ZHVILLIME TË TJERA

## Zhvillohet Mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF)

Synimi i memorandumit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional është të krijojë kushtet dhe stimujt e nevojshëm për të ndikuar gradualisht, por në mënyrë të qëndrueshme, në zvogëlimin e shkallës së përdorimit të monedhave të huaja dhe fuqizimin e monedhës kombëtare.

Në datën 18 prill 2017 u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje merrnin pjesë Ministri i Financave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Në mbledhje u prezantua vlerësimi mbi ecurinë financiare të sistemit bankar. Nisur nga nevoja për forcimin e përdorimit të monedhës vendase në ekonominë shqiptare dhe në sistemin financiar dhe për të konfirmuar angazhimin institucional në këtë proces sipas fushave përkatëse të veprimit, në mbledhje u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi midis drejtuesve të lartë të Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Synimi i memorandumit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional është të krijojë kushtet dhe stimujt e nevojshëm për të ndikuar gradualisht, por në mënyrë të qëndrueshme, në zvogëlimin e shkallës së përdorimit të monedhave të huaja dhe fuqizimin e monedhës kombëtare, në përputhje me qëllimin e forcimit të efektivitetit të politikës monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

## “Sfidat dhe Praktikrat e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Evropën Juglindore”, Konferenca e IV-t e Evropës Juglindore për mbikëqyrjen e sigurimeve

Instituti i Sigurimeve në Zagreb organizoi në datën 4 prill 2017 në Zagreb, Kroaci, Konferencën e IV-t të Evropës Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve me temë “Sfidat dhe Praktikrat e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Evropën Juglindore” (*Challenges and Practice of Insurance Supervision in South East Europe*). Pjesëmarrës në konferencë ishin përfaqësues të nivelit të lartë të autoriteteve homologe të mbikëqyrjes së sigurimeve nga vendet e rajonit dhe Evropa, si edhe përfaqësues të kompanive të sigurimit, menaxherë risku, aktuarë, ekspertë dhe studiues të tregut të sigurimeve.

Synimi i konferencës ishte diskutimi mbi zhvillimet dhe ndryshimet në praktikën e mbikëqyrjes së kompanive të sigurimit. Tematikat e diskutimeve u fokusuan në situatën aktuale të tregjeve të sigurimeve në Evropën Juglindore dhe prirjet e këtyre tregjeve, sfidat e *Solvency II*, mbikëqyrja në sigurime pas futjes së *Solvency II*, mbrojtja konsumatore brenda kuadrit të *Solvency II*, mbikëqyrja kombëtare në kushtet e mjedisit global si edhe përballja me sfidat e së ardhmes.

Në panele të veçanta të konferencës pati edhe prezantime nga vendet e ndryshme të rajonit për problematikat e tyre. AMF u prezantua në këtë konferencë me drejtues të lartë të saj.

Konferenca i shërbeu nxitjes së diskutimeve dhe ofroi mundësinë e një komunikimi konstruktiv midis mbikëqyrësve dhe kompanive të sigurimit.

## **AMF zhvillon më tej bashkëpunimin me Shoqatën e Siguruesve të Austrisë (VVO) dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA)**

Drejtues të lartë dhe ekspertë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në datat 18-19 prill 2017 zhvilluan në Vjenë një takim të përbashkët me Shoqatën e Siguruesve të Austrisë (VVO) dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Austrisë (FMA).

Në takimin me Shoqatën e Siguruesve të Austrisë (VVO), u prezantua mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni dhe u dhanë informacione rreth sigurimit të detyrueshëm motorik dhe praktikave në Austri. Në eksperiencën austriake, Shoqata e Siguruesve të Austrisë përfshihet si palë interesi gjatë procesit të hartimit të ligjeve, akteve rregullative, si edhe diskutimit me strukturat e qeverisjes të cilat prekin çështje që lidhen me tregun e sigurimeve.

Në nivel evropian, shoqata ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë procesit të zbatimit të sistemit të mbikëqyrjes “*Solvency II*”.

Gjatë takimit u trajtuan çështje lidhur me Teknologjinë e Informacionit, të dhënat mbi bazën qendrore të dhënave, mënyrën e raportimit, skemat e komunikimit mbi regjistrimin e një police sigurimi si dhe funksionimi i sistemit Bonus-Malus. Gjatë takimit përfaqësuesit e AMF-së prezantuan zhvillimet e tregut të sigurimeve në vitin 2016, si dhe Regjistrin Elektronik *Online* të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, Regjistrin e Dëmeve si dhe implementimin e sistemit *Bonus-Malus* nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në datën 19 prill u zhvillua takimi me Autoritetin Mbikëqyrës Financiare të Austrisë (FMA) ku u diskutuan çështje që lidhen me strukturën organizative, rolin dhe funksionet e FMA, çështje të raportimit dhe mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e AMF-së dhe FMA-së ndanë eksperiencat e tyre duke diskutuar ndër të tjera për formën dhe mënyrat e raportimit, përpunimin e informacionit dhe sistemet mbështetëse të teknologjisë së informacionit.

---

Gjatë takimit përfaqësuesit e AMF-së prezantuan zhvillimet e tregut të sigurimeve në vitin 2016, si dhe Regjistrin Elektronik Online të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, Regjistrin e Dëmeve si dhe zbatimin e sistemit *Bonus-Malus* nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

---

## AMF organizon trajnimin e TAIEX mbi abuzimin e tregut dhe tregtimin e brendshëm në fushën e titujve



Gjatë zhvillimit të trajnimit mbi abuzimin e tregut dhe tregtimin e brendshëm në fushën e titujve

○ ○ ○  
Trajnimi (*Expert Mission*) për legjislacioni e ri të BE-së në lidhje me abuzimet e tregut dhe tregtimin e brendshëm të titujve (*Market abuse and inside trading*).

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të aplikimit të instrumentit të asistencës teknike dhe shkëmbimit të informacionit (TAIEX), organizoi në datat 26-27 prill 2017, trajnimin (*Expert Mission*) për legjislacioni e ri të BE-së në lidhje me abuzimet e tregut dhe tregtimin e brendshëm të titujve (*Market abuse and inside trading*). Ky trajnim u organizua me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe në bashkëpunim me Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA). Trajnimi është pjesë e punës dhe strategjisë së AMF-së për forcimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të saj, njohjen e legjislacionit dhe praktikave më të mira në fushën e tregtimit të titujve financiarë.

Eksperti i MFSA Z. Edward Grech, Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Letrave me Vlerë dhe Tregjeve ishte trajner në këtë mision dhe prezantoi për stafin e AMF-së disa tematika të rëndësishme si:

- Kërkesat kryesore të regjimit të ri të abuzimit të tregut;
- Çështjet për tregtimin e brendshëm dhe shpërndarjen e paligjshme të informacionit të brendshëm;
- Direktivën mbi sanksionet penale për abuzimin e tregut;
- Ndryshimet dhe sfidat kryesore rregulatore duke përfshirë rritjen e monitorimit dhe mbikëqyrjes së platformave të tregtimit dhe instrumenteve financiare;
- Skenarët e mundshëm të manipulimit të tregut.

Gjatë seancave trajnuese u diskutua dhe u shkëmbyen eksperiencat në lidhje me zbatimin e rregullave të ndryshme mbi abuzimin e tregut dhe tregtimin e brendshëm në fushën e titujve. Tematikat e trajtuara në këtë mision përshtateshin edhe me zgjerimin me ritëm të shpejtë që tregu shqiptar i titujve ka pasur në vitet e fundit.

Ky është trajnimi i dytë që AMF zhvillon për stafin e saj në kuadër të aplikimit të instrumentit të asistencës teknike dhe shkëmbimit të informacionit TAIEX.



## Zhvillohet takimi i 27-të vjetor i Institutit të Rritjes dhe Zhvillimit të Tregut të Letrave me Vlerë

Komisioni i Letrave me Vlerë në SHBA (*Securities Exchange Commission, SEC*) zhvilloi gjatë periudhës 27 mars-6 prill 2017 në Uashington DC, takimin e 27-të vjetor të Institutit të Rritjes dhe Zhvillimit të Tregut të Letrave me Vlerë (*International Institute for Securities Market Growth and Development.*)

Z. Michael Piwovar, Komisioner pranë Komisionit të Letrave me Vlerë në SHBA, theksoi rëndësinë e tregut të letrave me vlerë në zhvillimin ekonomik të vendeve, duke filluar që nga roli i tij në krijimin e vendeve të reja të punës, deri në rritjen e standardit të jetës së brezave të ardhshëm. “Roli i rregullatorëve të tregut të letrave me vlerë ka si mision kryesor mbrojtjen e investitorëve, mbrojtjen e tregjeve, të cilat funksionojnë në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, si dhe lehtësimin e formimit të kapitalit” theksoi Z. Michael Piwovar.

Ndër çështjet kryesore të trajtuara në këtë takim ishin:

- Mbikëqyrja me bazë rrezikun;
- Qeverisja e korporatave;
- Praktikant më të mira në vetërregullim; perspektiva e FINRAS;
- Mbikëqyrja e organizatave që vetërregullohen;
- Struktura e tregjeve dhe tregtimi i kompjuterizuar;
- Bashkëpunimi midis rregullatorëve dhe autoriteteve kriminale;
- Investigimi i shkeljeve të ndërmjetësve (*Brokers/Dealers*) dhe këshilltarëve të investimeve.

Tema të tjera të trajtuara në këtë takim ishin edhe investigimi dhe ndjekja penale në rastet e abuzimit të tregut të kapitalit, investigimi dhe ndjekja penale në rastet e “*insider trading*”, investigimi dhe ndjekja penale e skemave të mashtrimit financiar, skemave Ponzy dhe skemave piramidale.

Një rëndësi e veçantë iu dha bashkëpunimit ndërkombëtar midis institucioneve mbikëqyrëse në zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve të legjisllacionit apo abuzimeve/mashtrimeve të ndryshme të tregut të letrave me vlerë nga aktorë të ndryshëm të tij.

Roli i rregullatorëve të tregut të letrave me vlerë ka si mision kryesor mbrojtjen e investitorëve, mbrojtjen e tregjeve, të cilat funksionojnë në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, si dhe lehtësimin e formimit të kapitalit.

## Metamorfoza e Greqisë dhe roli i industrisë së sigurimeve – Kujdestarët e së ardhmes?

Fjala e Z. Yannis Stourmaras, Guvernator i Bankës së Greqisë, mbajtur gjatë Forumit të Parë mbi Sigurimet organizuar nga “Ekonomisti” në Athinë, më 30 mars 2017

(Marrë me shkurtime dhe redaktime – Pjesa e parë)

Gjatë shtatë viteve të fundit, Greqia ka pësuar një ndryshim të thellë në formë, sikurse e përshkruan edhe fjala greke “metamorfoza”. Politikat e zbatuara në vitin 2010, në kuadër të tri programeve të rregullimit kanë ndihmuar në përbalimin e mungesës së ekuilibrave të mëdha fiskale dhe ato të jashtme, duke e kthyer deficitin dyshifror në një bilanc pozitiv gjatë viteve të fundit. Krahas kësaj performace janë arritur përmirësime të konsiderueshme strukturore në tregjet e punës dhe të produkteve, si edhe në administratën publike.

Sidoqoftë, metamorfoza nuk është e plotë. Greqia nuk ka qenë ende në gjendje të kthehet në një rritje të qëndrueshme dhe një parakusht për këtë është përfundimi i shqyrtimit dhe zbatimi i vendosur i programit. Kjo është sfida aktuale, e cila e bën zbatimin e reformave strukturore të vështira dhe here pas here duke çuar në ndryshimin e politikave.

Vuajtja e gjatë e sistemit grek të pensioneve është një shembull kryesor në këtë aspekt. Që prej vitit 2010 janë zbatuar të paktën tre reforma të rëndësishme, por shumë dispozita mbeten ende për t'u zbatuar plotësisht, ndërsa sistemi mbetet i shtrenjtë, i deformuar dhe i padrejtë.

Baza institucionale për zhvillimin e sistemit të pensioneve me shumë kolona ka ekzistuar në Greqi që prej vitit 2002 (Ligji 3029/2002). Megjithatë sistemi grek i pensioneve mbetet kryesisht me një kolonë të vetme, atë të pensioneve të detyrueshme, e cila siguron përfitime kryesore, ndihmëse dhe përfitime të tjera të pensionit. Sistemi funksionon sipas bazës *Pay-as-You-Go*. Kështu ky sistem është kryesisht i natyrës publike.

Reforma e sistemit të pensioneve e vitit 2010 forcoi rregullat e daljes në pension (për shembull, rriti moshën e daljes në pension, për disa tipe pensionesh në 60 dhe 65 vjeç, si edhe rriti vitet e kërkuara për plotësimin e kontributeve nga 35 në 40 vjet) dhe gjithashtu paraqiti një ndryshim strukturor, duke specifikuar një formulë unike, më pak të shtrenjtë pensionesh, e cila ishte përcaktuar të zbatohet në vitin 2015. Sipas kësaj formule përfitimet përcaktohen mbi bazën e kontributeve të derdhura gjatë gjithë jetës, duke zëvendësuar formulën e cila konsideronte vetëm pesë vitet më të mira të përzgjedhura nga punët e kryera gjatë dhjetë viteve të fundit. Në tërësi reforma forcoi lidhjen midis kontributeve dhe përfitimeve dhe zvogëloi bujarinë e pensioneve.

Reformat e mëtejshme në vitin 2011 dhe 2012 u hartuan për të ruajtur nivelet e shpenzimeve të pensioneve. Ato përfshinë edhe: heqjen e pensionit të 13-të dhe të 14-të për të gjithë pensionistët; ngrirjen e pensionit nominal deri në vitin 2016; shkurtimin e pensioneve që ishin mbi vlerat 1,000 euro dhe rritjen e moshës së daljes para kohe në pension dhe moshës ligjore të daljes në pension respektivisht në 62 vjeç dhe 67 vjeç.

Reforma e pensioneve në vitet 2010 dhe 2012 pritej të çonte në një korrigjim të

○○○  
Baza institucionale për zhvillimin e sistemit të pensioneve me shumë kolona ka ekzistuar në Greqi që prej vitit 2002 (Ligji 3029/2002). Megjithatë sistemi grek i pensioneve mbetet kryesisht me një kolonë të vetme, atë të pensioneve të detyrueshme, e cila siguron përfitime kryesore, ndihmëse dhe përfitime të tjera të pensionit.

○○○

ndjeshëm në rrjedhën financiare të sistemit të sigurisë sociale, duke ulur rritjen e parashikuar të shpenzimeve të pensioneve për periudhën 2010-2060 nga 12.5% të PBB-së (Sipas Raportit të plakjes së KE-së, 2009) në vetëm 1.3% të PBB-së (Sipas Raporti të plakjes së KE-së, 2015). Shkalla bruto e zëvendësimit (raporti i pensionit mesatar i pensionistëve të rinj në raport me pagën mesatare të pensioneve) pritet të zbresë nga 64% në 49% për pensionet kryesore dhe nga 15% në 8% për pensionet suplementare gjatë periudhës 2014-2060.

Sidoqoftë, duke gjykuar këto reforma, rezulton se ato nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente. Madje as rregulli i unifikimit për pensionet kryesore dhe as rregulli i bilancit zero për pensionet suplementare, nuk janë zbatuar ashtu siç ishte parashikuar. Shkurtime në pensione u gjykuan se ishin jo kushtetuese nga një Vendim i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në vitin 2015. Rritja e pragut të moshës së daljes në pension rezultoi joefektive, ndërkohë që opsionet e mëparshme të pensioneve të parakohshme kishin qenë në fuqi për një kohë shumë të gjatë dhe kjo çoi në një valë masive të njerëzve që dëshironin në dilyn në pension të parakohshëm për të përfituar nga rregullat më liberale të kohëve të mëparshme. Këto presione tek krahu i shpenzimeve, të kombinuara me rënien e kontributeve për shkak të nivelit të lartë të papunësisë, e vunë sistemin nën tension financiar, duke kërkuar transferta të mëdha vjetore nga buxheti i shtetit. Sipas të dhënave nga Eurostat (ESA 2010), totali i pagesave të kryera tek fondi i sigurimeve shoqërore nga nënsektorët e tjerë të administratës publike arriti në 7.1% të PBB-së në vitin 2015 (krahasuar me mesataren prej 3.3% të PBB-së të vendeve të eurozonës).

Përveç shpenzimeve të vazhdueshme, sistemi u përball me sfida strukturore, me bashkimin e fondeve që bartnin shkallë të ndryshme autonomie (me formula të tjera kontributesh dhe masa përfitimesh) ndërsa pensionet kanë mbetur me shumë shtresa, ku përshihen pensionet bazë, kontributive dhe pensionet minimale si dhe pensionet ndihmëse, ato me kontribute të paracaktuara, etj.

Si pjesë e marrëveshjes për rishikimin e parë të programeve aktuale, të gjitha formatet e para më lart u riadresuan në reformat e viteve 2015 dhe 2016, të cilat ndër të tjera legalizuan:

- Thjeshtimin e sistemit të sigurimeve shoqërore nëpërmjet konsolidimit të fondeve të kryesore në një entitet të vetëm të sigurimeve shoqërore (EFKA);
- Një formulë të unifikuar të llogaritjes së të ardhurave të pensioneve, si shuma e një pensioni bazë (384 euro, e cila i korrespondon nivelit të varfërisë në vitin 2014, dhe 20 viteve kontribute) dhe një komponent kontributiv i cili aplikon normat e akumuluar të kthimit (marginal accrual rate) mbi kontributet;
- Rregulla të reja për llogaritjen e pensioneve suplementare duke aplikuar, midis të tjerave, edhe shkurtime selektive dhe një ngrirje të pensioneve, për sa kohë fondet të jenë me deficit;

- Një ndryshim në bazën e kontributeve për të vetëpunësuarit dhe fermerët, në të ardhurat aktuale për subjektet e vetëpunësuar dhe në kufirin minimal të të ardhurave;
- Rritjen në kontributet shëndetësore deri në 6% për pensionistët;
- Rritjen për kontributin e pensioneve suplementare deri në mes të vitit 2022;
- Eliminimi gradual i pensionit social, jo-kontributiv EKAS, deri në fund të viti 2019; dhe
- Një formulë të re, më pak liberale për përlogaritjen e përfitimeve me shuma të caktuara të pensionit.

Kjo na sjell në rrethanat aktuale, në mars 2017, me shqyrtimin e dytë dhe reformën e sistemit të pensioneve në axhendën e reformave.

## Bosnje-Hercegovinë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Sigurimeve e Bosnje-Hercegovinës (BiH)AZOBiH tregojnë se gjatë vitit 2016 volumi i përgjithshëm i primeve të shkruara bruto për 27 siguruesit në vend u rrit me 6.4% në terma vjetorë duke arritur në 324.2 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara bruto për 13 kompanitë që operojnë në Federatën e Bosnje-Hercegovinës u rrit me 5.2% duke arritur në 228.4 milionë euro. Ndërsa në Republikën Serbe të Bosnjës (RS) vepron 14 kompani sigurimi, të cilat gjeneruan së bashku rreth 95.8 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 9.4% në terma vjetorë.

Tregu i sigurimeve të Jetës zuri rreth 20.4% të totalit të primeve me një vlerë prej 66.1 milionë euro. Nga ato 55.4 milionë euro u krijuan nga kompanitë e sigurimit të Jetës në Federatën e BiH dhe rreth 10.7 milionë euro, nga siguruesit e Jetës së RS.

Nga primet e sigurimit të Jo-Jetës, 8.4% e primeve të përgjithshme bruto ishin nga sigurimi i pronës dhe 59.4% nga sigurimi motorik (Sigurimi Kasko dhe MTPL).

Sipas shifrave të paraqitura nga Agjencia e Sigurimeve e Bosnje-Hercegovinës, në Federatën BiH, shoqëria UNIQA Osiguranje, pjesë e grupit austriak UNIQA, ishte siguruesi më i madh në vend, e cila raportoi volumin më të lartë të primeve të shkruara bruto prej 29.9 milionë euro ose 9.2% të tregut.

Siguruesi më i madh i Republikës Serbe të Bosnjës ishte WIENER Osiguranje, një njësi e kompanisë austriake VIG e cila arriti vlerën e primeve të shkruar bruto prej 16.1 milionë euro ose 5% të tregut.

## Gjeorgji

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas Shoqatës së Kompanive të Sigurimeve të Gjeorgjisë, tregu i sigurimeve gjeorgjiane u rrit me 9.24% gjatë vitit 2016, ndërsa gjatë vitit 2015 kjo rritje kishte qenë prej 19%. Ky zhvillim ishte pasojë e zvogëlimit të volumit të biznesit të raportuar për disa nga linjat e sigurimit si sigurimi i përgjithshëm i automjeteve që së bashku përbëjnë rreth gjysmën e totalit të tregut. P.sh. norma e rritjes për Sigurimin Kasko ishte 6% në vitin 2016, ndërsa në vitin 2015 kjo normë rritjeje ishte rreth 32%; Rritja e MTPL-së në vitin 2016 ishte 12%, ndërsa në vitin 2015 ky indeks u rrit me 39%, sigurimi i pronës u ul me 5.7%. Sigurimi i Jetës në vitin 2015 raportoi rritje prej 50%, ndërsa në vitin 2016 vëllimi i primeve të shkruara bruto mbeti i pandryshuar.

Proceset e zhvlerësimit të monedhës gjatë kohëve të fundit kanë ndikuar negativisht në tregun e sigurimeve dhe në normën e humbjeve të pësuar. Zhvlerësimi i monedhës vendase ka ndikuar kryesisht në sigurimin shëndetësor dhe atë motorik. Shumë nga treguesit në përbërje të çmimit të produkteve apo shërbimeve të sigurimit janë në varësi të drejtpërdrejtë me kursin e këmbimit të monedhës.

Prej 1 marsit 2017, në programin e kujdesit universal shtetëror shëndetësor janë bërë disa ndryshime, duke parashikuar përjashtimin e kompanive private nga programi i sigurimit shëndetësor shtetëror.

## Serbi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Banka Kombëtare e Serbisë njoftoi se gjatë vitit 2016 volumi total i primeve të shkruara bruto nga siguruesit aktive në treg u rrit me 10.15% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në rreth 722 milionë euro.

Të ardhurat nga primet e sigurimit të Jetës u rritën me 19.4%, duke zënë 26% të totalit të primeve, ndërsa primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 7.2%. Në sigurimet e Jo-Jetës ritmin më të lartë të rritjes e patën sigurimi i kredive, sigurimet motorike dhe sigurimi i shëndetit. Sigurimet e detyrueshme MTPL zunë rreth 34% të totalit të tregut.

Vlera totale e dëmeve të paguara për të gjitha kompanitë e sigurimet në Serbi gjatë vitit 2016 u rrit me 8.7% në terma vjetore.

## Slloveni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të fundit të publikuara nga Agjencia Sllovene e Sigurimeve, SIA, në fund të dhjetorit 2016, siguruesit sllovene arritën një volum të primeve të shkruara bruto prej rreth 2.03 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 1.5% në terma vjetorë.

Për të njëjtën periudhë, vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit ra me 0.6% duke arritur në 1.35 miliardë euro, nga të cilat 950 milionë euro lidhen me sigurimet e Jo-Jetës dhe 407 milionë euro ishin dëme të paguara në sigurimin e Jetës.

Në totalin e primeve të shkruara bruto, rreth 28% e zinin primet e sigurimit të Jetës nga të cilat rreth 15.7% ishin sigurime të Jetës të lidhura me skema investimesh dhe 12.9% ishin sigurime të Jetës sipas policave tradicionale.

Sigurimet e Jo-Jetës zinin 71.7% të totalit të primeve të shkruara bruto, nga të cilat 12% lidhej me sigurimin e pronës dhe 11% me sigurimin e detyrueshëm motorik.

Tre kompanitë e sigurimeve me volumin më të madh të primeve të shkruara bruto përbëheshin nga kompanitë me aksionarë sllovenë.

**amf** ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)